



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

NR. 03 ,Dt. 13.03.2019

MBI DHËNIEN NË HUAPËRDORJE TË GODINËS NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË NË FAVOR TË INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË

Bazuar në gërmën “e” të nenit 77 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” me propozim të Kryesisë të Këshillit të Qarkut Korçë.

V E N D O S I

1. Të miratojë dhënien në huapërdorje të godinës në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, me kusht që në katin e parë të godinës të sistemohen edhe institucionet: Zyra e Përmbarrimit Shtetëror Korçë, Zyra e Statistikës Korçë dhe Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor.
2. Periudha për të cilën godina do të lihet në huapërdorje institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë do të jetë 5 vjet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kabineti i Kryetarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI



Konceptoi : Gj.Kristo
Sekretar i K.Qarkut: B. Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

Në zbatim të VKM Nr. 601 datë 31.08.2016 është miratuar shkëmbimi i ndërtesave respektive midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë. Për rregullimin e situatës së krijuar faktike dhe ligjore nga ky shkëmbim, Këshilli i Qarkut Korçë pas shqyrtimit të nevojave të tij për ambientet e reja ku do transferohet dhe do ushtrojë aktivitetin, me mirëkuptim ka rishikuar mundësinë edhe për ambientet e nevojshme për institucionet apo agjencitë e tjera të sistemuara aktualisht në ndërtesën ekzistuese, e cila tashmë i ka kaluar në pronësi Bashkisë Korçë. Në këto kushte pas kërkesës për tu siguruar ambiente për ushtrimin e funksioneve të tyre nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë dhe institucionet e tjera të sistemuara në godinën ekzistuese, është arsyetuar që pjesa e ndërtesës e cila i ka kaluar në pronësi Këshillit të Qarkut Korçë pas shkëmbimit të godinave me Bashkinë Korçë, ti lihet në huapërdorje institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë me kusht që në katin e parë të godinës të sistemohen edhe institucionet: Zyra e Përmbarimit Shtetëror Korçë, Zyra e Statistikës Korçë dhe Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, pasi Këshilli i Qarkut Korçë ka siguruar të drejtën e huapërdorjes për pjesën tjetër të godinës ku ushtronte funksionet Bashkia Korçë. Në këto kushte bazuar në gërmën “e” të nenit 77 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kryesia i propozon Këshillit të Qarkut Korçë miratimin e dhënies në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë të godinës, e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë, me kusht që në katin e parë të godinës të sistemohen edhe institucionet e sipërpërmendura.

Konceptoi:

Gjergji Kristo